



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet tjera

Maj 2018

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Etika Gjyqësore

Më 02 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, në mbështetje të projektit: “Programi i USAID për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP)” ka realizuar trajnimin për gjyqtarët e regjionit të Gjilanit me temë “Etika Gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ofrimi i informatave më të hollësishme mbi Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë përmes diskutimeve dhe prezantimit të rasteve, me qëllim që gjyqtarët të jenë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë korrekte dhe të drejtë në pajtim me dispozitat e Kodit të Etikës për Gjyqtar.

Me rastin e këtij trajnimi vëmendje parësore iu kushtua rasteve hipotetike duke identifikuar sjelljet e pahijshme dhe njëkohësisht duke

zbrërthyer dispozitat e Kodit të Etikës për Gjyqtar veçanërisht të komunikimet midis një pale dhe gjyqtarit, përdorimi i mediave sociale, marrja e një dhurate, madje edhe e një vlere minimale, të cilat mund të krijojnë perceptimin e publikut se ekziston korrupsioni në sistemin gjyqësor.

Gjatë trajnimit si nga trajnuesit ashtu edhe nga gjyqtarët pjesëmarrës u theksua se gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të matur në mënyrë që të veprojnë me integritet, si në jetën e tyre private ashtu edhe në jetën profesionale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët nga Gjykata Themelore në Gjilan duke përfshirë edhe gjyqtarët nga degët si Vitija dhe Kamenica.



Etika Gjyqësore

Më 03 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, në bashkëpunim me Programin e USAID-it për fuqizimin e sektorit të drejtësisë në Kosovë - JSSP, ka realizuar trajnimin për gjyqtarët e regjionit të Prizrenit dhe Gjakovës me temë “Etika Gjyqësore”.

Qëllimi i trajnimit ishte ofrimi i informatave të hollësishme për zbatimin e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, diskutimeve dhe prezantimit të rasteve hipotetike, ti avancojnë njohuritë e pjesëmarrësve në fushën e etikës gjyqësore.

Gjatë trajnimit vëmendje parësore iu kushtua rasteve hipotetike duke identifikuar sjelljet e

pahijshme, dhe njëkohësisht duke zbërthyer dispozitat e Kodit të Etikës për Gjyqtar veçanërisht te komunikimet midis një pale dhe gjyqtarit, përdorimi i mediave sociale, marrja e një dhurate, madje edhe e një vlere minimale, të cilat mund të krijojnë perceptimin e publikut se ekziston korrupsioni në sistemin gjyqësor.

Gjatë trajnimit u theksua gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të matur në mënyrë që të veprojnë me integritet si në jetën e tyre private ashtu edhe në jetën profesionale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 44 gjyqtarë, nga Gjykatat Themelore në Prizren dhe Gjakovë duke përfshirë edhe gjyqtarët nga degët e këtyre gjykatave.



Hetimet financiare

Më 3 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e BE-së “Mbështetje e mëtejme për Institucionet e Kosovës, në luftën kundër Krimit të organizuar, Korrupsionit dhe Ekstremizmit të dhunshëm, i realizuar nga B&S Europe, ka mbajtur trajnimin me temë “Hetimet financiare”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me veprimet parandaluese që duhet të ndërmerren për të luftuar ndikimin e krimit financiar, si dhe hartimin e planit hetimor për luftimin e krimit financiar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe evazionit fiskal.

Në fokus të trajnimit ishte trajtimi i krimit financiar si një ndër krimet më serioze, që kanë për qëllim të atakojnë zhvillimin ekonomik të

shoqërisë. Si formë e kriminalitetit manifestohet në forma të ndryshme si: korrupsioni me të gjitha karakteristikat, pastrimi i parave, evazionet fiskale, prokurimi publik etj.

Të gjitha veprat penale që ndërlidhen me krimet financiare, kryhen duke mos njohur sundimin e ligjit, dhe menjëherë shkaktojnë parregullsi brenda vet sistemit. Shtetet i japin hapësirë të konsiderueshme luftimit të këtyre dukurive ngase të gjitha janë shkatërruese dhe vazhdimisht kanë tendencë të shtrirjes për t'i atakuar vlerat e shtetit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorë nga niveli i Apelit si dhe gjyqtarë dhe prokurorë nga niveli themelor, nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Etika Gjyqësore

Më 04 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, në bashkëpunim me USAID, projekti Programi për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë – JSSP, ka realizuar trajnimin për gjyqtarët e regjionit të Pejës me temë “Etika Gjyqësore”.

Qëllimi i trajnimit ishte ofrimi i informatave të hollësishme për Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, diskutimeve dhe prezantimit të rasteve hipotetike, ti avancojnë njohuritë e pjesëmarrësve në fushën e etikës gjyqësore.

Trajnimi u realizua nëpërmes trajtimit të rasteve hipotetike, përmes të cilave janë identifikuar sjelljet e pahijshme dhe njëkohësisht, janë

zërthyer dispozitat e Kodit të Etikës për Gjyqtar veçanërisht të me palë, përdorimi i mediave sociale, marrja e një dhurate, madje edhe e një vlere minimale, të cilat mund të krijojnë perceptimin e publikut se ekziston korrupsioni në sistemin gjyqësor.

Gjatë trajnimit u theksua gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të matur në mënyrë që të veprojnë me integritet si në jetën e tyre private ashtu edhe në jetën profesionale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 34 gjyqtarë, nga Gjykatat Themelore në Pejë, duke përfshirë edhe gjyqtarët nga degët e kësaj gjykate.



Renta, llojet dhe caktim i saj

Më 08 maj 2018, Akademia e Dritësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshëm, realizoi trajnimin me temë “Renta, llojet dhe caktim i saj”



Qëllim i trajnimit ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrëseve lidhur me rentën dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që lidhen me atë.

Trajnimi filloi duke trajtuar rentën dhe kuptimin e saj, kushtet që duhet të plotësohen për këtë kategori të dëmit dhe përfituesit e saj. Ndërsa tutje, trajnimi u fokusua në mënyrat e vlerësimit, caktimit të lartësisë, format e realizimit të rentës bazuar në rastet nga praktika gjyqësore.

Po ashtu vend me rëndësi gjatë trajnimit zuri edhe diskutimi rreth zbatimit të drejtë të dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e

Detyrimeve që rregullojnë llojet e dëmit me theks të veçantë për rentën, kushtet që duhet të plotësohen për këtë kategori të dëmit, përfituesit, mënyra e vlerësimit, caktimi i lartësisë dhe format e realizimit të rentës.

Gjatë trajnimit u theksuan edhe kontestet e shpeshta që paraqiten në praktikën gjyqësore për shkak të shpërblimit të dëmit dhe njëra prej kategorive të paraqitura të dëmit material është edhe renta. Renta si formë e shpërblimit të dëmit shpeshherë përbën sfidë për gjykatën në kuptimin e të vlerësuarit për nevojat e caktimit të rentës dhe në kuptim të caktimit të vëllimi të saj. Përveç kësaj, sfiduese paraqitet edhe mënyra e të provuarit dhe forma e caktimit të saj.

Trajnimi u zhvillua me debat interaktiv, u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj nga praktika e përditshme gjyqësore.

Përfitues ishin gjyqtarë të gjykatave themelore, nga regjione të ndryshme të Kosovës si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Masat e diversitetit

Më 10 maj 2018, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e UNICEF-it, në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë: “Masat e diversitetit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve, që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, të ngritën kapacitetet profesionale me qëllim të shqiptimit të masave të diversitetit.

Trajnimi u realizua me qëllim të definimit të kushteve për shqiptim të masave të diversitetit, vlerësimit të masave adekuate për situatat specifike, dhe identifikimit se ndaj kujt dhe për çfarë vepra mund të shqiptohen këto masa.

Gjatë këtij sesi u trajtua legjislacioni vendor, me theks të veçantë Kodi i Drejtësisë për të

Mitur, ku u theksuan mangësitë dhe problemet në zbatimin praktik të masave të diversitetit.

Në këtë kontekst u diskutua pëlqimi i të miturit për shqiptim të masës së diversitetit, prezenca e të miturit, prindit dhe mbrojtësit në seancë për shqiptim të masës së diversitetit, dhe marrja e aktvendimit për shqiptim e masave të diversitetit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.

Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër krimit kibernetik - Sesioni 1

Më 10-11 Maj 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e parë të trajnimit të specializuar për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër krimit kibernetik.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që të kuptojnë natyrën dhe format e krimit kibernetik si dhe veprat penale që janë të ndërlidhura me krimin kibernetik.

Sesion i parë i trajnimit ka filluar duke prezantuar krimin kibernetik në përgjithësi, për të vazhduar tutje me infrastrukturën ligjore dhe

institucionet përkatëse që mund të ndihmojnë në luftimin e kësaj dukurie, qoftë në nivel vendor si Këshilli Kombëtar në kuadër të MPB-së kundër Krimit Kibernetik, i cili ka hartuar Strategji për 2016-2019, mandej Forenzika Kibernetike në kuadër të Policisë së Kosovës, si dhe institucionet dhe mekanizmat e domenit ndërkombëtar si Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik (Konventa e Budapestit e 23 nëntorit 2001) dhe shumë organizata ndërkombëtare dhe nisma rajonale aktive në luftimin e krimit kibernetik.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan krimi kibernetik dhe sfidat në luftimin e tij, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës së krimit kibernetik, ndërlidhjen e këtij krimi apo shfrytëzimi i sistemit informativ në kryerjen e veprave tjera të ndërlidhura penale.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, të regjioneve të ndryshme të Kosovës.



Zbatimi i legjislacionit tatimor në Kosovës

Më 16-17 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me KPMG-Projekt i mbështetur financiarisht nga Qeveria e Luksemburgut dhe në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, realizoi trajnimin me temë: “Zbatimi i legjislacionit tatimor në



Kosovës”.

Qëllimi konkret i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional lidhur me zbatimin e drejtë të legjislacionit tatimor.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtua korniza ligjore e tatimit në Kosovë dhe baza kryesore për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat e korporatave, rregullimet kryesore të tatimeve nga autoritetet tatimore dhe transferimi i çmimit. Ndërsa në ditën e dytë u vazhdua me trajtimin marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë - njësia e përhershme, tatimi në burim për jo-rezidentët, tatimin në burim për

qira, të drejta pronësore dhe interes si dhe normat e tatimit mbi të ardhurat personale dhe llogaritjet.

Në trajnim gjithanshëm u zërthyen dispozitat e Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, të cilat përcaktojnë se cilët subjekt konsiderohen si tatimpagues në Republikën e Kosovës. Gjithashtu u zërthyen edhe dispozitat e Ligjit për Tatimin në të Ardhura Personale i cili vendos sistemin e tatimit në të ardhurat personale në territorin e Republikës së Kosovës.

Po ashtu gjatë dy ditëve pjesëmarrësit të ndihmuar nga trajnuesit morën pjesë në diskutimin dhe trajtimin e disa rasteve ku ata ofruan zgjidhje lidhur me kërkesat që përmbanin e që ishin dedikuar çështjeve tatimore dhe zgjidhjes së tyre efektive. Gjatë gjithë kohës nga trajnuesit janë ofruar shpjegime me vlerë nga këndvështrimi i legjislacionit në fuqi dhe praktikës gjyqësore dhe administrative vendase dhe ajo e shteteve në rajon lidhur me tematiken e përmendur.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Departamentit për çështje administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe ata të Departamentit për çështje administrative të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional si dhe prokurorë të nivelit themelor



Sekuestrimi dhe konfiskimi

Më 17 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, në mbështetje të GIZ, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Sekuestrimi dhe konfiskimi”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëmarrës në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore me të cilat janë sanksionuar veprat penale që ndërlidhen me krimin e organizuar, korrupsionin, si dhe problemet të cilat paraqiten në praktikë me qëllim që të zbatohen në mënyrë unike dispozitat ligjore në fuqi.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua rëndësia e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve si provë, si mjet me të cilin është kryer vepra penale apo si dobi pasurore e fituar me vepër penale. Vëmendje iu kushtua masave që mund të propozohen për sigurimin e pasurisë dhe cilat janë masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, për të cilin prokurori i shtetit ka prova të artikulueshme që tregojnë dyshim të bazuar se është përdorur në veprën penale nën hetim, është provë e veprës penale nën hetim, ose është fituar nga vepra penale nën hetim.

Paraprakisht përmes shembujve u analizuan metodat për identifikimin e aseteve dhe procesi i sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve të fituara me vepër penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Legjislacioni për pyjet, mbrojtjen e natyrës dhe mbrojtjen e ambientit

Më 22 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë: “Ligji për Pyjet e Kosovës, mbrojtjen e natyrës dhe mbrojtjen e ambientit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e drejtë të dispozitave të legjislacionit për pyjet, për mbrojtjen e natyrës, me theks në mbrojtjen e parqeve kombëtare si dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë trajnimit vëmendje e veçantë iu kushtua interpretimit të burimeve të së drejtës mjedisore në Kosovë si një degë e veçantë e sistemit juridik dhe garancioneve kushtetuese dhe ligjore të së drejtës në mjedis, qasjes në informacione mjedisore, pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe drejtësisë mjedisore. Po ashtu pjesëmarrësit u njohën me nivelin e zbatimit të Konventës së Aarhusit në Kosovë, instrument ky që detyron shtetet anëtare të sigurojnë qasje në informacione mjedisore, për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në çështjet që lidhen me mjedisin, dhe për të siguruar qasje në drejtësi me qëllim të mbrojtjes ligjore të këtyre të drejtave dhe të drejtave të

përgjithshme në fushën e mjedisit.

Në trajnim u veçua konkludimi se duke pas parasysh faktin se jemi dëshmitarë të degradimit të ambientit, të dëmtimit të pamëshirshëm të pyjeve, të parqeve kombëtare dhe natyrës në përgjithësi, e që krejt kjo reflektohet detyrimisht në shëndetin e njeriut dhe në kualitetin e jetës në përgjithësi, është e nevojshme që lëndët nga kjo lëmi të trajtohen, me prioritet nga ana e gjykatave të Kosovës.

Në vazhdim u shtjelluan edhe të gjeturat dhe rekomandimet nga raportet e BE-së për Kosovën, të viteve të fundit të cilët potencojnë se ndonëse Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes në këtë fushë në kuadër të të cilës janë shënuar disa përparime, nevojiten akoma përpjekje të konsiderueshme për të zbatuar legjislacionin në të gjitha fushat e ndryshimit të mjedisit dhe klimës.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në gjykatat themelore, nga departamentet e përgjithshme - divizionet penale dhe prokurorë të nivelit themelor.

Sinjalizimi dhe mbrojtja e burimeve të gazetarëve

Më 24-25 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me projektin “Përforcimi i ekspertizës gjyqësore mbi lirinë e shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore” - JUFREX, organizoj trajnimin me temë: “Sinjalizimi dhe mbrojtja e burimeve të gazetarëve”.



Qëllimi i trajnimit ishte zgjerimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me të drejtën e lirisë së shprehjes me fokus në rregullimin e shpifjes që bëhet përmes mediave.

Gjatë këtij sesioni trajnues u trajtuan sinjalizimi sipas Këshillit të Evropës dhe iniciativa për direktivë evropiane për mbrojtje të sinjalizuesve, standardet e GJEDNJ-së në mbrojtjen e sinjalizimit, si dhe kush konsiderohet sinjalizues. Me theks të veçantë u

sqarua se cilat janë parakushtet, që të mund të gëzojë mbrojtje një sinjalizues? Kufiri në mes të lirisë së shprehjes dhe ruajtjes së konfidencialitetit në kontekst të punës, si dhe testi i GJEDNJ-së në rastet e sinjalizimit.

Gjatë trajnimit vëmendje iu kushtua edhe kornizës ligjore vendore për mbrojtjen e sinjalizuesve, Ligjit për mbrojtjen e informatorëve dhe nenet relevante në Kodin Penal. Në kuadër të këtij sesioni trajnues u trajtua edhe mbrojtja e burimeve të gazetarëve sipas Këshillit të Evropës dhe korniza ligjore vendore për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve. Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive me ç’rast u elaboruan raste praktike të sinjalizuesve dhe raste praktike në mbrojtjen e burimeve të gazetarëve ku pjesëmarrësit kishin mundësi të paraqesin pikëpamjet nga këndvështrimi i tyre rreth temës së shtjelluar dhe implementimin në praktikë të njohurive të përfituara nga ky trajnim.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelore si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Trajnim lidhur me Komunikimin

Me 30 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasaden e Mbretërisë së Holandës në Prishtinë, po realizojnë trajnimin për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive lidhur me Komunikimin.



Qëllimi i trajnimit është ngritja e aftësive personale të komunikimit, identifikimi i kohës së duhur për angazhimin e gjyqtarit dhe prokurorit në media, si dhe identifikimi i mjeteve dhe kanaleve të duhura përmes të cilave

informohen gazetarët.

Gjatë trajnimit janë duke u trajtuar temat si gjyqtari përgjegjës për komunikim me shtyp në Holandë, tregon ngjarjen pjesërisht, instrumentet që përdoren për informimin e publikut, përdorimi i këtyre instrumenteve – hartimi i komunikatës për media në lidhje me ndonjë vendim.

Trajnimi po zhvillohet duke u zbatuar metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik dhe krahasimor në mes vendeve, gjithashtu gjatë trajnimit do të ketë ushtrime praktike duke stimuluar pjesëmarrësit të hartojnë komunikatë për media si dhe diskutimi i rasteve dhe vendosja se në çfarë mënyre të komunikimit do të përdorin ata.

Përfituës të trajnimit janë Kryetarët e gjykatave dhe Kryeprokurorët e prokurorive të nivelit të Apelit dhe nivelit themelor, si dhe gjyqtar nga Gjykata Supreme.



Kontrata e ndërtimit

Më 31 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoj trajnimin me temë “Kontrata e ndërtimit”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me kontratën e ndërtimit.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan karakteristikat e kontratës së ndërtimit dhe specifikat e tyre; kushtet e përgjithshme-kushtet e veçanta të kontratës dhe klauzola “çelësi në dorë”. Ndërsa në pjesën e dytë u vazhdua me trajtimin e ndryshimeve të çmimeve për shkak të ndryshimeve në treg; procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave, dhe mënyrat si dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rast të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së tyre.

Në trajnim u potencua se kontrata për ndërtimin sipas natyrës juridike është një lloj i veçantë i kontratës. Sa i përket përgjegjësisë për mungesat në ndërtim, përshtatshmërisht zbatohen rregullat ligjore mbi kontratën për veprën. Kontrata për veprën është kontratë themelore, ndërsa kontrata për ndërtimin konsiderohet kontratë derivative.

Ndërsa për formën me shkrim të kontratës për

ndërtimin u theksua se ka efekt konstitutiv, meqenëse është kusht i vlefshmërisë së kontratës. Përveç pasojave juridike, mosrespektimi i formës me shkrim tërheq pasoja ndëshkuese. Kjo do të paraqiste kundërvajtje ekonomike – delikt ekonomik, i cili është i sanksionuar me dënim me të holla – gjobë. Në vazhdim u potencua se kontratat mbi ndërtimin dhe kontratat e inxhinjeringut, aktualisht kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e ndërtimit duke pasur parasysh fazën e rindërtimit të vendit.

Gjithashtu në trajnim u potencua se këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçanta me rastin e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkojnë njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata, për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga raporti afarist i krijuar përmes këtyre kontratave.

Në vazhdim u veçua konstatimi se në praktikën gjyqësore, numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është e një rëndësie të veçantë për të avancuar njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e këtyre rasteve.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit së bashku me trajnuesit morën pjesë në një debat të frytshëm dhe interaktiv lidhur me pyetjet dhe paqartësitë e ngritura përmes analizës së dispozitave ligjore dhe mënyrave si duhet zbatuar drejtë ato në praktikë, gjithashtu u përdoren edhe metoda e shpjegimit të pjesshëm teorike dhe raste nga praktika gjyqësore.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore - departamentet e përgjithshme- divizionet civile dhe bashkëpunëtorët profesional.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivite e realizuar në muajin maj në trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar

Akademia e Drejtësisë, ka vazhduar përbushjen e programit të trajnimit për gjyqtarët e sapoemëruar, duke realizuar në këtë formë aktivitete trajnuese të cilat kanë përfshirë trajnimin teorik dhe atë praktik për muajin maj, ashtu siç ishin planifikuar me program.

Komponenta e trajnimit teorik, për këtë periudhë, është përbushur duke realizuar aktivitetet si në vijim: nën-moduli “Mbrotjtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës është realizuar përmes dy (2) sesioneve trajnuese, nën-moduli “E drejta familjare“ një (1) sesion trajnues, nën moduli “E drejta administrative” pesë (5) sesione trajnuese, nën moduli “E drejta e detyrimeve” nëntë (9) sesione trajnuese, si dhe nën moduli “Ligji për kundërvajtje” një (1) sesion trajnues.

Në kuadër të nën modulit “Mbrotjtja gjyqësore në konteste nga marrëdhënia e punës” përkatësisht në sesionin dy dhe tre ndër të tjera janë shtjelluar: natyra juridike e kontesteve të punës, legjislacioni në fuqi, fusha e zbatimit dhe llojet e kontratave të punës (akt emërimeve) sipas Ligjit për Shërbimin Civil, shkaqet e shkëputjes së marrëdhënies së punës, procedurën gjyqësore që zhvillohet tek kontestet e punës, llojet e vendimeve, afatet, mjetet juridike, përgjegjësitë e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, sigurimin e kushteve për mbrotjtje në punë, informimin e punëmarrësve për të drejtat e tyre, të drejtat e punëmarrësve etj.

Nën-moduli “E drejta e Detyrimeve”, synon që gjyqtarëve të sapoemëruar tu ofrojë një ndihmesë në avancimin e njohurive të tyre në zbatimin praktik të dispozitave ligjore në fushën e detyrimeve. Gjatë muajit maj janë trajtuar: karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve, kontratat e detyrimeve, shuarja e kontratave, mbajtja e përjetshme, kontrata mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, shkaktimi i dëmit si burim i detyrimeve, shpërblimi i demit,

shpërblimi i dëmit të pësuar në aksidentet në punë dhe kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit - padia pauliana.



Në këtë periudhë gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar trajnimin nga nën moduli “E drejta administrative” i cili ka trajtuar tema që i përkasin procedurës administrative dhe nxjerrjes së aktit administrativ, që i përket organeve të administratës, ndërsa pjesa tjetër ka përfshirë konfliktin administrativ në përgjithësi e që zhvillohet pranë gjykatës kompetente administrative, e cila përfshin seancën e shqyrtimit kryesor dhe marrjen e aktgjykimit në shkallën e parë, si dhe mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike gjithnjë sipas Ligjit për Konfliktet Administrative.

Në kuadër të trajnimit praktikë, për këtë periudhë është realizuar trajnimi përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykatat përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program. Gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë muajit maj po ashtu kanë realizuar trajnimin praktik në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Administratën Tatimore të Kosovës të cilët kanë pasur mundësi të diskutojnë për rolin, strukturën dhe problemet e shfaqura në praktikë. Po ashtu në këtë periudhë gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar një tryezë diskutimi lidhur me Udhëzuesin e Politikave Ndëshkimore të Gjykatës Supreme.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 54 gjyqtarë të sapoemëruar, ku pesë prej tyre janë nga komuniteti serb.

Aktivitet e realizuar në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar gjatë muajit maj

Akademia e Drejtësisë, në drejtim të përbushjes së prgramit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara për muajin maj, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e sapoemëruar të shtetit.



Gjatë muajit maj 2018, në kuadër të trajnimit teorik, janë zhvilluar aktivitetet si në vijim: është realizuar nën moduli “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, përmes shtatë (7) sesioneve trajnuese, nën-moduli “Aktakuza – procedura e shqyrtimit” tri (3) sesione trajnuese, nën moduli “Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale” pesë (5) sesione trajnues, dhe kallëzimi penal, një (1) sesion trajnues.

Në kuadër të nën modulit “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut” janë elaboruar këto tema: Neni 5 par.1 i KEDNJ - Prezumimi në favor të lirisë, garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, Neni 6.1, 6.2 dhe 6.3, pastaj neni 8,13 dhe 14 i KEDNJ. Po ashtu nga nën moduli “Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale” janë trajtuar: zgjerimi dhe rifillimi i hetimeve, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, dëshmitarët dhe procedimi i tyre gjatë fazës së hetimeve, mundësia hetuese e veçantë, dhe ngrirja dhe sekuestrimi si veprim procedural gjatë fazës së hetimeve.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, në kuadër të nën modulit “Aktakuza – procedura e shqyrtimit”, janë shtjelluar elementet e

domosdoshme të aktakuzës si dhe të drejtat e të pandehurit pas pranimit të aktakuzës. Përmes këtij nën-moduli, sidomos me pjesën praktike synohet të arrihet përgatitja e prokurorëve, në mënyrë që të njëjtit mos të kenë pengesa dhe paqartësi në hartimin dhe prezantimin e akteve akuzuese gjatë punës së tyre. Nën moduli “Kallëzimi penal” është realizuar përmes një sesioni trajnues ku prokurorët e sapo emëruar ka pasur mundësi të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me kallëzimin penal si akt iniciues i procedurës penale, dallojnë kallëzimin penal nga format tjera të raportimit, si dhe të vendosin drejtë mbi kallëzimin penal.

Gjatë realizimit të këtyre sesioneve trajnuese, u aplikua një metodologji e kombinuar duke përfshirë ligjërime teorike dhe diskutime interaktive, ku prokurorët e sapoemëruar ngritën edhe dilema të cilat po ashtu i vërejnë gjatë fazës praktike të trajnimit në prokuroritë përkatëse. Përmes detyrave dhe ushtrimeve praktike, ata u angazhuan në përgatitjen e rasteve të ndryshme.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktikë, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e prokurorëve të sapoemëruar në prokuroritë përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program. Prokurorët e sapo emëruar gjatë muajit maj kanë realizuar trajnimin praktik në Policinë e Kosovës, të cilët kanë pasur mundësi të diskutojnë për rolin, strukturën dhe problemet e shfaqura në praktikë.

Trajnimin fillestar për prokurorët e sapo emëruar janë duke e ndjekur 22 prokuror të sapoemëruar, ku tre prej tyre janë të komunitetit serb.

Trajnimi praktik në Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Më datën 2 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, ka realizuar trajnimin praktik në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët e sapoemëruar të njoftohen me procedurat e privatizimit të subjekteve të AKP-së, rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit, verifikimin dhe shpalljen e fituesit të përkohshëm, aprovimin dhe refuzimin e ofertës, dhe informata të përgjithshme për procesin e privatizimit dhe likuidimit në Kosovë.

Gjithashtu gjatë trajnimit, janë trajtuar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme problemet

aktuale në praktikë, duke njohur dhe kuptuar më mirë rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit në Kosovë dhe zbatimin e drejtë të procedurave për privatizimin e subjekteve.

Trajnimi ishte interaktiv në çdo fazë të tij, me ç' rast gjyqtarët e sapo emëruar kishin mundësinë të paraqesin dhe diskutojnë çështje me interes me të cilat ata mund të ballafaqohen në praktikën e tyre me lëndët e kësaj natyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Trajnimi praktik i prokurorëve të shtetit të sapo emëruar në Policinë e Kosovës

Më 02 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për prokurorët e sapoemëruar ka organizuar trajnimin praktik në Policinë e Kosovës.



Trajnimi në këtë institucion, kishte për qëllim që prokurorët e sapoemëruar të avancojnë njohuritë e tyre rreth mandatit, rolit, strukturës dhe punës praktike të Policisë së Kosovës.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua roli që ka Drejtorati i Inteligjencës në Policinë e Kosovës,

dhe për strategjitë e aprovuara që do të kontribuojnë viteve të ardhshme në luftimin e kriminalitetit.

Vëmendje iu kushtua rasteve nga praktika, sidomos për narkotikët dhe substancat psikotrope, rastet e shumta që hasen sidomos gjatë kalimit të pikave kufitare, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar që ka Kosova me shtetet e tjera.


Mbështetur në faktin që puna e prokurorëve është e ndërlidhur ngushtë me punën e Policisë, prokurorët e sapoemëruar kishin rastin që të ngritin çështje me interes për punën e tyre praktike, për bashkëpunimin aktual dhe formave adekuate të bashkëpunimit në të ardhmen mes Policisë dhe Prokurorive përkatëse

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e shtetit të sapoemëruar gjenerata e VII.



Trajnimi praktik - Administrata Tatimore e Kosovës

Më datën 23 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, ka realizuar trajnimin praktik në Administratën Tatimore të Kosovës.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, funksionin dhe përgjegjësitë e Administratës Tatimore të Kosovës

Në kuadër të këtij trajnimi praktik u prezantua një historik i shkurtër rreth themelimit, organizimit, dhe funksionimit të saj, baza ligjore mbi të cilën funksionon ky institucion si dhe sfidat aktuale me të cilat ballafaqohet në drejtim të përmbushjes së mandatit të saj.

Më tej në mënyrë të hollësishme, u trajtuan shmanga nga tatimi, tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi në të ardhurat personale, tatimet e mbajtura në burim, kontributet pensionale, dhe dhënia e licencave për lojërat e fatit.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç ‘rast gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të shtrojnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Udhëzuesi për politikën ndëshkimore

Me datën 30 maj 2018, në kuadër të trajnimit fillestar, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, kanë realizuar trajnimin me temë “Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore”.



Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me përmbajtjen e Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore i cili, është hartuar dhe publikuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, që kanë të bëjnë me vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjatë trajnimit u trajtua korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare, e veçanërisht udhëzimet që

përmban Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore që kanë të bëjnë me vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese, mënyra e vlerësimit të këtyre rrethanave, sqarim i tabelës për matjen e dënimit e cila është pjesë e udhëzuesit, përfitimet e përdorimit të udhëzuesit, përshtatshmëria dhe pesha e rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, si dhe obligimi për qasje të harmonizuar në matjen e dënimit.

Theks i veçantë në këtë trajnim u vu tek vlerësimi i rrethanave rënduese si; shkalla e pjesëmarrjes së kryesit në veprën penale, shkalla e dashjes, kombinimi i rrethanave lidhur me viktimën, shkalla e dëmit të shkaktuar, recidivizmi etj., ndërsa tek rrethanat lehtësuese u trajtuan kontributi i viktimës, rrethanat personale të kryesit, mosha, pranimit i fajit etj.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapoemëruar që janë duke ndjekur trajnimin fillestar.



Aktivitetet tjera

Trajnim i Trajnuesve të Programit për Trajnim Fillestar “Trajnimi fillestar i bazuar në raste”

Më 2-3 Maj 2018, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme reformës për arsimim ligjor” të BE-së, ka realizuar trajnimin për gjyqtarët dhe prokurorët e fushës civile dhe penale, njëherit trajnues të Programit të Trajnimit Fillestar në Akademinë e Drejtësisë



me temë “Trajnimi i bazuar në raste”.

Në kuadër të këtij trajnimi së pari, u prezantua struktura e Programit të Trajnimit Fillestar me fokus në ndryshimin e metodës së mbajtjes së këtij trajnimi përmes rasteve praktike. Trajnuesit shpjeguan përmes shembujve

mënyrën e realizimit të një pjese të caktuar të fushave të së drejtës ose të procedurave përmes rasteve praktike.

Gjithashtu, në kuadër të këtij trajnimi u shtjelluan mundësitë e përgatitjes dhe niveli i angazhimit të trajnuesve, si dhe u prezantuan praktikatat më të mira të trajnimit përmes rasteve praktike si mënyrë më efektive e bartjes së njohurive praktike tek gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar.

Po ashtu, pjesëmarrësve ju caktuan detyra në grupe punuese, të ndarë sipas fushave të së drejtës (civile dhe penale) me fokus në zhvillimin e rasteve praktike përmes së cilave ata do t'i trajnojnë përfituesit e trajnimit fillestar, pjesë të caktuara të procedurave ligjore.

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi u shprehën të kënaqur dhe të interesuar që të vënë në përdorim metodën e trajnimit përmes rasteve praktike në të ardhmen në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar në Akademinë e Drejtësisë.



Barazia gjinore në procedure gjyqësore

Më 03 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me GIZ, realizoi tryezën e diskutimeve “Barazia gjinore në procedure gjyqësore”.

Qëllim i tryezës ishte njohja me gjendjen e përgjithshme të barazisë gjinore nga konteksti juridik, gjyqësori dhe profesionet e lira, si dhe njohja me problemet dhe sfidat në zbatimin e kornizës ligjore të barazisë gjinore në punën e përditshme.

Pjesëmarrësit në këtë tryezë kanë diskutuar rreth sfidave në zbatimin e legjislacionit në fuqi, specializimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, hetuesve policor, punëtorëve social, mbrojtësve të viktimave në fushën e barazisë gjinore, Ligji për Barazi Gjinore i cili kërkon pjesëmarrjen e 50 % të grave në nivel vendimmarrës në jetën politike dhe publike, mungesën e përfaqësimit të barabartë gjinor përbrenda sistemit gjyqësor dhe

prokurorial, e në veçanti nevoja që në trupat gjykues të ketë gjyqtare femra.

Gjatë diskutimeve të pranishmit kanë theksuar nevojën e vazhdimit të masës afirmative lidhur me regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve. Krahas ekzistimit të infrastrukturës ligjore, pjesëmarrësit kanë konstatuar se e drejta e grave për trashëgimi përballet me zbatim të dobët të ligjit për trashëgimi.

Pjesëmarrës në tryezë ishin përfaqësues të institucioneve të ndryshme si: gjyqtarë, prokurorë nga Prokuroria e Shtetit, Zyra për Mbrojtjen e Viktimave, Oda e Përmbauesve Privat, Oda e Noterëve, Institucioni i Avokatit të Popullit, dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës.



Komunikimi dhe qasja ndaj palës

Më 15 maj 2018, Akademia e Drejtësisë sipas kërkesës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në mbështetje të UNDP-së ka realizuar trajnimin e parë për zyrtarët e këtij institucioni me temë: “Komunikimi dhe qasja ndaj palës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte trajtimi me dinjitet i palëve që kërkojnë ndihmë juridike duke zbatuar drejtë parimet ligjore dhe etike të sjelljes.

Në këtë trajnim u vunë në pah afirmimi dhe ngritja e dinjitetit dhe imazhit të ofruesit të ndihmës juridike falas përmes përgjigjes së shpejtë ndaj kërkesave të dorëzuara nga palët, ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit që është në disponim, pa cenuar zbatimin e detyrimeve që dalin nga legjislacioni që ka të bëjë me qasje në dokumente zyrtare, ruajtjen e privatësisë, sjelljen në mënyrë profesionale si

dhe duke respektuar parimin e barazisë së palëve, mos diskriminimin dhe instrumentet tjera ndërkombëtare të cilat janë të zbatueshme sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjatë trajnimit pati raste praktike si dhe simulim të rasteve të cilat në grupe punuese u elaboruan nga pjesëmarrësit e këtij trajnimi duke marrë për bazë parimet ligjore dhe etike të sjelljes.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Gjakova, Mitrovica, si dhe Podujeva. Përveç tyre ishin edhe nga OJQ si CRPK, CLARD si dhe Femrat Aktive të Gjakovës.



Trajnimi për trajnues në fushën e lirisë së shprehjes dhe media

Me 17-18 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e KE-së “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore – JUFREX”, ka realizuar trajnimi për trajnues “Liria e shprehjes dhe medias”.



Qëllimi i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve të trajnuesve, në fushën e lirisë së shprehjes bazuar në standardet e GJEDNJ, konkretisht parimet bazë të lirisë së shprehjes dhe kushtet për kufizimin e saj, shpifja, e drejta e qasjes në dokumente publike dhe sinjalizimi.

Gjatë dy ditëve të trajnimit janë trajtuar parimet bazë të lirisë së shprehjes dhe kushtet për kufizimin e saj - zbatimi i testit tre hapësh në grupe të vogla, e drejta për qasje në informacion, diskutim për metodologjinë dhe përmbajtjen e trajnimit, mbrojtja e sinjalizuesve - testi gjashtë hapësh si dhe shpifja.

Trajnimi është zhvilluar nga ekspertë të Këshillit të Evropës të specializuar në fushën e lirisë së shprehjes duke u bazuar në doracakun për trajnim, i cili është hartuar nga projekti JUFREX i Këshillit të Evropës.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga Kosova, trajnues të Akademisë së Drejtësisë si dhe gjyqtarë dhe prokurorë nga Shqipëria.



Punëtori për rishikimin e modulit Drejtësia për fëmijë aspekti penal

Më 10-11 maj 2018, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të UNICEF-it ka realizuar “Punëtorinë për rishikimin e modulit Drejtësia për Fëmijë - aspekti penal”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte rishikimi i modulit trajnues i cili është në aplikim nga Akademia e Drejtësisë, dhe përshtatja e tij me ndryshimet e reja të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, i cili gjatë zbatimit do të shoqërohen me raste nga praktika me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtareve dhe prokurorëve.

Punëtorja u realizua me qëllim të identifikimit të nevojave të plotësimit të modulit Drejtësia për të Mitur nga lëmia penale, duke u bazuar në

ndryshimet që përmban projekt Kodi i Drejtësisë për të Mitur.

Vëmendje gjatë punëtorisë iu kushtua disa risive që do të sjell Kodi i ri i Drejtësisë për të Mitur i cili pritet që të hyjë në fuqi së shpejti. Paraprakisht, pjesëmarrësit ndan temat e modulit të cilat do t'i përshtaten ndryshimeve për të qenë në përputhje me këtë projekt kod.

Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga gjykata Supreme dhe gjykata e Apelit si dhe prokurorë të nivelit themelor, autorë të Modulit Drejtësia për Fëmijë – aspekti penal.



Punëtori rajonale për statistikat e së drejtës penale lidhur me krimin kibernetik dhe provat elektronike

Më 14-15 maj 2017, në kuadër të projektit iPROCEEDS, në Bukuresht të Rumanisë është mbajtur “Punëtori rajonale për statistikat e së drejtës penale lidhur me krimin kibernetik dhe provat elektronike”.

Qëllimi i punëtorisë ishte njoftimi i pjesëmarrjeve rreth rolit dhe rëndësisë së statistikave, analizimit të shifrave dhe trendeve për krimin kibernetik, dhe provat elektronike, sa janë thelbësore në përcaktimin e nivelit të kërcënimeve të paraqitura nga format e ndryshme të krimit kibernetik, për të mbështetur hetimet, ndjekjet më efektive si dhe për të informuar më mirë hartuesit e politikave strategjike.

Fillimisht në punëtori kanë prezantuar sektori i policisë Njësi Kundër Krimit Kibernetik nga vendet e Evropës Juglindore dhe Turqia, ku janë paraqitur raporte, regjistrimi i statistikave, mbledhjes dhe analizës së drejtësisë penale - procedurat aktuale, sfidat dhe mundësitë. Gjithashtu janë paraqitur sistemet e raportimit të krimit kibernetik, korniza institucionale për grumbullimin e të dhënave dhe statistikave, mënyrën se si ndahen të dhënat me organizata të tjera nga sektori publik dhe privat.

Punëtorja ka vazhduar me paraqitjen e të dhënave, raporteve, regjistrimit të statistikave,

mbledhjes dhe analizës së drejtësisë penale - procedurat aktuale, sfidat dhe mundësitë e prokurorisë. Gjatë prezantimit prokurorët kanë prezantuar, nëse legjislativi i tyre vendor e njih apo jo si vepër të veçantë penale krimin kibernetik, janë paraqitur sistemet e raportimit të krimit kibernetik, korniza institucionale për grumbullimin e të dhënave dhe statistikave, mënyrën se si ndahen të dhënat me organizata të tjera nga sektori publik dhe privat, praktikatat aktuale, dhe sfidat në këtë fushë.

Në lidhje me raportimin, regjistrimin e statistikave, mbledhjes dhe analizës së drejtësisë penale - procedurës aktuale, sfidave dhe mundësive ka raportuar edhe sektori i CERTS – Computer Emergency Response Team.

Po ashtu janë paraqitur edhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, krahasimi dhe analiza - modeli estonez, përcaktimi i metodologjisë për mbledhjen dhe analizën e statistikave mbi krimin kibernetik dhe provat elektronike.

Në këtë punëtori morën pjesë gjyqtar, prokuror, zyrtar policor nga departamenti për krimin kibernetik, zyrtar nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Akademia e Drejtësisë.



Menaxhimi i rrjedhës së lëndëve

Më 23 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, bazuar në kërkesën Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në mbështetje të UNDP-së ka vazhduar trajnimin e dytë me radhë për zyrtarët e këtij institucioni me temë: “Menaxhimi i rrjedhës së lëndëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i planifikimit dhe bashkërendimit të gjitha proceseve me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë dhe kryerjen e rasteve në afat ligjor apo të arsyeshëm.

Me rastin e këtij trajnimi nga ana e trajnuesve u vunë në pah përparësitë e menaxhimit të drejtë të rasteve duke theksuar në rend të parë lehtësimin e punës në institucion, eliminimin e situatave jo të dëshirueshme, rritjen e efikasitetit të punës dhe eliminimin e humbjes së kotë të kohës. Në këtë drejtim po ashtu kontribut të rëndësishëm në menaxhimin e rasteve u theksua

edhe krijimi i një ambient të mirë kolegjial i cili pa dyshim ndikon në rritjen e besimit të publikut në institucionin përkatës.

Gjatë trajnimit pati raste praktike të cilat në grupe punuese u elaboruan nga pjesëmarrësit e këtij trajnimi fillimisht duke paraqitur problemet praktike gjatë menaxhimit dhe njëkohësisht duke paraqitur propozimet për zgjidhjen e problemeve të evidentuara..

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Gjakova, Mitrovica, si dhe Podujeva. Përveç tyre ishin edhe nga OJQ si CRPK, CLARD si dhe Femrat Aktive të Gjakovës .



Sistemi Gjyqësor në Kosovë

Më 29 maj 2018, Akademia e Drejtësisë, bazuar në kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në mbështetje të UNDP-së, ka vazhduar trajnimin e tretë me radhë për zyrtarët e këtij institucioni me temë: “Njoftim i përgjithshëm për Sistemin Gjyqësor në Kosovë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja me etapat e zhvillimit historik të reformës gjyqësore në Kosovë, që nga viti 1999 e deri në ditët e sotme, duke përfshirë legjislacionin në fuqi dhe strukturën aktuale të gjykatave dhe prokurorive, si dhe kompetencat e tyre.

Me rastin e këtij trajnimi nga ana e trajnuesve u vunë në pah struktura e gjykatave sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Kosovës, kompetencat dhe funksionet pas hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, organizimi i sistemit gjyqësor sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe së

fundmi sipas ligjit aktual për Gjykata. Në këtë drejtim po ashtu u vunë në pah problemet që i përcjellin gjykatat, si dhe ndryshimet pozitive qoftë në menaxhimin e punës ashtu edhe në zbatimin e drejtësisë.

Gjatë trajnimit pati diskutime të shumta edhe nga pjesëmarrësit, veçanërisht në çështjet që janë fushëveprim i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, si dhe çështje tjera lidhur me materien e trajtuar.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Gjakova, Mitrovica, si dhe Podujeva. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin edhe nga pjesëtarë të OJQ-ve si CRPK, CLARD si dhe Femrat Aktive të Gjakovës.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**